

EDITORIAL

Ministër Kulture apo...?



Nga ZYHDI MORAVA

Si gur i shkullur nga dherat e veta, ai, ka marrë tatëpjetën në rrokullimën e së keqes. Të së keqes që vetes ia krijoji me lakminë e babëzinë e tij, karakteristikë kjo e njerëzve pa moral krijues, me prirje jo njerzore: "Unë rrofsha sa malet, të tjerët në djall vafshin! Kësaj bote mbi-jetojnë më të fortët. A s'thotë kështu dhe Darvini?"

Kësaj rradhe po merreme me njërën nga ato veprime të këtij ministri, që na nxit të ngremë një shqetësim tonin, i cili s'ka mos hedhë hije dyshimi mbi të. Po të hysh në godinën e Ministrisë së Kulturës, tashmë të zbukuruar si një nuse e sapo dalë nga banja, lyer, pispillosur e zhivosur, me ta hedhur pragun, në murin e majtë, syri të kap disa foto me dimensione të mëdha e me diçiturën: "Ja si ka qenë!" Në

ato foto me përmasa të mëdha duken disa pamje vërtet të shëmtuar të asaj godine, kohës ku ishte lënë në mëshirë të fatit, pa asnjë fond nga shteti, pa asnjë meremetim, edhe se, me ç'dimë, ajo godinë e ndër-tuar në vitin 1931, hynte në fondin e objekteve që mbrohen nga shteti. Me këtë gjë, pra, vend e pavend, rast e pa rast, mburret ministri aktual i (anti) kulturës, një farë Ylli Pango, për të cilin, ç'nuk thonë... E ç'na hyn ne në punë se ç'thonë të tjerët për të?

Por, ne nuk mund ta kapërdijmë mburrjen idiote se e paska rregulluar atë godinë, e cila sot quhet Ministri e Kulturës, me një shumë të hollash që varion nga 600 deri në 700.000 euro. As gurgullimën e tij përçmuese kundrejt shkrimtarëve tanë. As mbylljen represive të gazetës së vetme e më të lashtë letraro-kulturore me emrin aq të nderuar DRITA. Ky veprim është një tjetër tregues që na orienton drejt urrëjtjes që ky ministër ka për letërsinë shqipe, për zhvillimin e saj, një ministër al-ergjik ndaj çdo shkrimtari, i cili, kështu, tërthorazi, na thotë se nuk ka interesin më të vogël për autorët tanë, se nuk i lexon ata, duke shfaqur padituri-ligësi-servilzmën e tij me thënien se, në Shqipëri, paska vetem një shkrimtar...
(vijon ne faqen 2)

"...Dhe drita e diturisë përpara do të na shpjerë..."

Naim FRASHËRI

NJË DITË E BUKUR PRILLI

(Në Ditën Ndërkombëtare të Librit)

NJË LAJM I GËZUESHËM NGA ULQINI

Të nderuar miq!
Të premtën, më 11 prill 2008, doli nga shtypi **ABETARJA PER FEMIJET E KOP-SHTEVE**. Autor i kësaj abetarje është Gazmend Çitaku, redaktor Hajro Ulqinaku ndërsa konsulentë janë Arian Leka (Tiranë) dhe Florinda Basha (Ulqin). Ky libër është botim i "Asociacionit Ulqini" nga Ulqini i cili merret me botime shqipe kryesisht të autorëve nga Ulqin-iakë. Është e vërtetë e pamohueshme që femijët në Mal të Zi nuk kanë tekste mësimore dhe tekstet nga hapsira tjetër shqiptare nuk lejohen në shkolla dhe institucione mësimore dhe femijët në atë gjendje që të mesojnë nga tekste në gjuhën sllave.

Ky është libri i parë i kushtuar parashkollorëve dhe është punuar sipas standardeve më të larta bashkëkohore, bazuar në eksperiencën europiane të edukimit 9 vjeçar.

ABETARE PËR FËMIJËT E KOPSHTEVE



Vili

Tregim nga Musa Vyshka

Dashuria

Tregim nga Anton Pashku

NËN LISIN PERËNDIMOR

Tregim nga Aleksandër Papadimantis (Greqi)

Buzëqeshje e trishtuar

Poezi nga Timo MERKURI

Dhe jetë e lot e dashuri


Poezi nga autorë botërorë, përkthyer nga Sotir Caci



Bashkëbisedim: Abedin Dino dhe Jashar Qemali

Elvira Dones

Lule të gabuara



Speciale/Visare nga Kosova

faqe 6-9

SHPLLJE KONKURSI LETRAR

Me rastin e 70-vjetorit të ndarjes nga jeta të poetit tonë të madh MIGJENI, Unioni i Shkrimtarëve Shqiptarë shpall konkursin letrar si më poshtë:

- PËR POEZINË

Çmimi i parë 500 euro
Çmimi i dytë 300 euro
Çmimi i tretë 200 euro

- PËR TREGIMIN

Çmimi i parë 500 euro
Çmimi i dytë 300 euro
Çmimi i tretë 200 euro

- PËR PËRKTHIMIN

Çmimi i parë 500 euro
Çmimi i dytë 300 euro
Çmimi i tretë 200 euro



Materialet të dërgohen të kompjuterizuara dhe me shënimin "Për konkursin". Afati i fundit i pranimit është 20.08.2008. Fituesit do të shpallen më 28 gusht 2008.

Logosi i fjalës poetike

Mbi librin më të ri poetik të Gjekë Marinajt, 'Lutje në ditën e tetë të javës', Faik Konica, Prishtinë, 2008)

Ndue Ukaj, Suedi


Në komunitetin e kritikës letrare, ekzistojnë pikpamje për letërsinë, sipas së cilave, forma e shkrimit që përkufizohet si poezi, është përfaqësim i letërsisë që ka vlera estetike (kritika e re anglo-amerikane) dhe se vlera e saj lidhet me realizimin e funksionit emotiv të gjuhës. Pra, gjuha, përveç se është esencë për letërsinë, për poezinë, veçanërisht është vetëidentifikim e objekt, përfaqësimi dhe sintetizimi i gjitha niveleve tjera që përcaktojnë e definojnë si zhanër letrar. Duke përjashtuar rrëfimin, poeti përmes gjuhës evokon situata, ide e ndjenja poetike, përmes trajtave shprehëse emocionale. Janë këto elemente që e bëjnë këtë formë shkrimi një art specifik letrar.

Në fakt, duke qenë "letërsia një lloj i veçantë gjuhe apo një përdorim i veçantë i saj" (Jonathan Culler), poezia, si zhanri themelor i letërsisë vlerësohet si manifestim më praktik i fjalës, që fokusohet tek gjuha, semantika evokuese e saj, me një vëmendje të posaçme në parimet organizuese të tingullit dhe ritmit. Poezia apo arti i orakujve, shprehja më sublime që simbolizon modusin tematik (Northrop Frajji), kjo mbretëreshë e sublimes estetike tejkalon përmasat e zakonshme të ligjëritimit njerëzor dhe hynë funksionalisht në rrafshin universal, për t'i inkuorporuar konceptet metafizike e transcendentale, nëpërmjet domethënive të përtjeshme, figurative, filozofike. Poeti, në cilësinë e orakullit evokon me gjuhën e së bukurës dhe sublimes perceptimet për jetën e universin.

Këto perceptime dhe observime poetik i gjejmë të sintetizuara në librin me poezi të Gjekë Marinajt, "Lutje në ditën e tetë të javës" ku kënaqësia e tekstit dhe institucioni i tekstit (Roland Barthes), sintetizojnë parimet themelore të një poetike të konsoliduar estetike. Ky interkomunikim i shpërfaqur në titull, korrespondon në esencë me dimensionin semantik e estetik të letërsisë së tij dhe njëherit implikon konceptet universale për krijimin, të cilat poeti i ndërlidh në kontekstin e një kodi kulturo, i cili ka referencë ka atë bibliik. Poezia e Marinajt mbetet arenë afreskesh, ku gërshetohen e bukura dhe e këndshme (Dulce et Utule sipas Horacit), mesazhi dhe semantika e tekstit, tingulli dhe ritmi funksional, elemente këto të cilat i japin dinamik tekstit poetik, në pikëpamje ideore, ndërsa krijojnë synesa ritmike të posaçme, në aspektin e formës poetike. Ky vëllim poetik që në titull implikon nivelin e leximit intertekstual të poezisë, që këtu nënkupton kontekstin e shtatë ditëve të krijimit bibliik. Kjo lojë poetike, përveç se reflekton konceptet për krijimin, këtë akt të magjishëm, e sforcon aktin krijues deri në kod kulturologjik, universal e të përtjeshme: poeti Marinaj ia shton krijimit Hyjnor një ditë për vete (dhe krijuesit), nga shtatë ditët e krijimit bibliik, ngase kësaj përbushet plotënia e universit, apo:

"Engjëjt të zbresin nga parajsja e të bëhen poetë" ("Lutja e së djelës")

Për faktin e thjeshtë se poezia është "shpirt i zbardhur gjerë në shpirt" dhe "lëshon tinguj marramendës nga kontakti i filozofisë me ndjenjën" ("Poezia"), së këndejmi shkakton katharsisin e nevojshëm letrar, sepse, sugjeron Marinaj, misioni i artistit është, që të



"ndihmoj": "Kafshët të zbuten/ e të bëhen humanë" ("Lutje e së dielës")

Ndër elementet e rëndësishëm të poetikës së Marinajt mbeten akti imagjativ i bashkëdyzuar me shenja e simbole empirike, të cilat i japin tekstit poetik tonalitet të theksuar dhe krijojnë një dinamik specifike tekstuale. Ky aspekt poetik, në plotëni është i konsoliduar dhe realizuar përmes një sistem figurativ të konstruktuar me potencë të fuqishme kreative e frymëzim; me nuanca të fuqishme intelektuale e kulturologjike. Kjo nënkupton se poezia e tij automatikisht paraqet koncepton apo i dedikohet lexuesit të kultivuar, një sintetizim të lexuesit empirik dhe model të letërsisë (Umberto Eco). Në esencialitetin e saj, poetika e Marinajt, është e krijuar me vokacion të kultivuar, ndjeshmëri të thellë dhe tension të fuqishëm dhe e bën këtë poet, krejtësisht veçantë dhe model në poezinë e sotme shqipe. Poezia e vëllimit poetik "Lutje në ditën e tetë të javës", është e organizuar në cikle poetike, parimet e së cilës mbështeten në njëtrajtshmërinë e toposave dhe rrjetit tematik. Më tutje, në pikëpamje të formës, lirika e Marinajt mbart në vete konceptin përsosmërisë ritmike, një parimi organizues simetrik, ku gradacioni poetik dhe aluzionet e vargjeve në përpikëri gërshetohen me harmoninë mes përmbajtjes dhe formës, dimensionit semantik dhe artistik të figurës, vargut dhe vjershës në tërësi (poezitë "24 orë dashuri" dhe "Bisedë me vdekjen"). Madje, mund të themi se Marinaj na del më specifik se kushdo në komunitetin tonë letrar, i pakrahasueshëm me format dhe mënyrën si e organizon materien poetike, si e koncepton temën e si i mishëron vargjet me figura dhe sistemin e brendshëm të rimimit dhe ritmit. Këto elemente i japin lirikës së tij gradacionin shumëformësh, ndërsa vargjet përçojnë kuptime ekoivoke. Dimensionin e kësaj përmasë poetik, variohet në trajta të ndryshme të diskursit poetik, brendapërbrenda një sistem vargëzimi të përpunuar, ndërsa merr përmasë kuptimore tragjike, ta zëmë, tek vjersha "Sot u lind Frederik Rreshpja", përmes së cilës Marinaj skalit vargjet nga më të fuqishme e poezisë shqipe:

"Poetit i pat humbur me kohë harmonia e trupit

Me mendjen. Koordinimi i shpirtit Me vargun, jo. E gjithë kjo në plat-formën

Që luciferi patë projektuar për poetët shqiptar"

Në të vërtetë, poezia e Marinajt në tërësinë e saj referencën e ka të etab-

luar në vetë qenien e poezisë, në artin e shkrimit, në artin e empirisë dhe universit, aty ku gjendet siç do thoshte Umberto Eco bota e madhe e librit. Në fakt, ky është Olimpi i poezisë së Marinajt, ndërsa ai zgjerohet vazhdimisht dhe prek thellësitë e magjisë së botës së librit, nuancat e dashurisë dhe perceptimet për të bukurën që sjell kjo ndjeshmëri. Më tutje, poezia e Marinajt evokon fuqishëm kodet e mëdha poetike, ato që janë shenja të përhershme semiotike e semantike të tekstit letrar, Homerin, Danten, Gëten, Neruden, Fishtën, Migjenin, e shumë të tjerë, me të cilët interkomunikon, në rrafshin e diskursit dhe dimensionit semantik. Këndej pari, ky soj vargësh konoton fuqishëm në aspektin kuptimor dhe shpërfaq ambivalencën poetike që tërheq paralele, gjithnjë në funksion të sub-stancës së lirikës dhe intencës ideore:

"Marlow më ka bërë shumë nder me Faustus

Tani i njoh mirë vlerat e shpirtit, kostot e dijes"

("Autoportret i avancuar").

Në fakt, zbërthimi i këtyre esencave, sjell vargun dramatik, i cili na implikon disa nivele tekstesh intertekstuale e interdiskursive, ngase vargjet (teksti poetik) krijojnë relacione të ndërmjetvetshme e funksionale me tekste e njohura në kulturën e shkrimit letrar:

"Të më falë Miltoni, por për mua do të ishte më mirë

Të jem shërbëtor në parajsë se sa sundues në ferr".

("Autoportret i avancuar").

Këto perceptime poetike, Marinaj i sforcon brendapërbrenda një kod të madh letrar. Prandaj, me shpirtin e artistit të madh e sofistifikon vargun estetikisht, i jep përmasë të thellë kuptimore, do të thosha krijon vargjet emblematisht, sikundër nga fuqia ideore, ashtu edhe fuqia stilistike-letrare:

"Sa herë jep shpirt një poet diçka vdes brenda meje"

("Me Neruden pranë Atlantikut").

Duhet përmendur se poezia shqipe e dy dekadave të fundit, duke u liruar nga dogmat e krijuara në art e letërsi, ka shënjuar ngritje të ndjeshme, sikundër në planin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Kemi një sërë poetësh që kanë hyrë në botën e letërsisë, me prirje të fuqishme novatore stilistike, duke zgjeruar komunikimin poetik dhe pikërisht në këtë kontekst, shkrimtari Gjekë Marinaj shënjon një moment të ri në poezinë shqipe, duke i sjell poezisë elemente të reja, origjinale, bashkëkohëse dhe specifike, brenda korpusit të letërsisë shqipe të dy dekadave të fundit. Poet elegant, me shprehje të përpunuar filozofiko-meditative, Marinaj në artin e tij shkrin dogmat për artin, drejtë një intencë sublime poetike: krijimit të artit të esencave origjinal, duke i kundruar brenda sistemit estetik. Dhe këto esenca i percepton me shije të hollë estetike, i kundron nga këndet më të ndjeshme dhe më dridhmuese, për t'i sintetizuar me gjuhën e së bukurës dhe këndshmes (Horacit). Këndej pari, poezia e tij shënjon një raport të nderligjshëm e kuptimor mes semantikës së gjuhës dhe gjetjes së fjalës adapte, e cila pastaj ngjeshet me figurën dhe përplotëson qëllimin poetik. Toposi i temave dhe rrjeti tematik i poezisë së Marinajt është i shumanshëm. Uni lirik kalon nëpër tri rrethet Dantiane, drejtë shkrirjes së tyre dhe prehjes në lumturinë e poezisë, këtë lumturi që ja dhuron fuqia e letërsisë dhe qëllimi

i saj përtej çdo qëllimi praktike.

Për poetin, dashuria në trajtat më të fuqishme rrezaton plotësinë, ajo është vetë bukura. Në poezinë "Vajzat" poeti shpërfaq diskursin idilik, një trajtë lirike të bukur që kurdoherë e përcjell poezinë e Marinajt, edhe kur ajo tejkalon përmasat e poezisë së dashurisë dhe merr konotacione meditative-filozofike, sikundër ngjet tek poezi "Dusitës, në 14 vjetorin e Martesës"

"Pa vajzat-diejt dhe hijet e vetë bukurisë, Dashuria dotkurrej në një gëzhojë vezake" ("Vajzat")

Ky rrjet toposesh e motivesh ndeshet kudo në poezinë e Marinajt. Madje, nuancat e dashurisë reflektojnë dimensionin ideor të palcës së poetikës së tij, për të mos thënë se ky rrjet toposesh përbën boshtin e librit.

Poetika e Marinajt karakterizohet nga diskursi shumëplanësh ligjërimit, dimensionin lirik bashkëdyzuar me trajtat e ligjëritimit përshtkruar, trajta këto që i japin ritëm e sistem ritmik cilësor dhe funksional. Poezia e Marinajt shquhet për realizimin metafizik. Kjo poezi duke patur për observime të përbashkëtën e njerëzimit, me nerv lirik, thërmon esencat e filozofisë së jetës, së këndejmi edhe filozofisë së shkrimit, sikundër tek poezia "Vija ndarëse me Emily Dickinson-in", ku Marinaj spikat efektin konceptual të vargjeve:

"O rret plakën tek i kthejnë mendimet në dëborë/ Dëborë vjetrohët tek flakëron e menduar në erë/ Unë, pa kuptuar, jam poli i ngrirë e veriu tënd".

Një aspekt cilësor dhe jashtëzakonisht të arrirë në kuadrë të këtij vëllimi poetik përbëjnë poezitë për artin poetik, poezinë, prozën, poetin, për qenien e letërsisë, pastaj ato lirika kush-tuar figurave të njohura, sikundër "Homeri", "Migjenit", "Nëna e poetit Luigj Çeka dha shpirt", poezitë për Fishtën, Rreshpajn, Dalan Lucajn, Neruden etj. dhe pastaj ato për Shkodrën, për Nënë Terezën, për Gjergj Kastriotin, Rozafën, për Shqipërinë, Kosovën, Nju Jorkun. Këto poezi i shquan dhe i përshkon frymëzimi i thellë, sikundër shihet tek poezia për Shkodrën, apo dy vjershat e bukura për Nënë Terezën.

Kështu, poezia e tij aq sa mbetet moderne është posmoderne, endet mes klasikes e simbolikës, mes lirikës dhe trajtave epike, mes shkollës letrare shkodrane dhe amerikane, mbi të gjitha, teksti poeti ndërtohet mbi parimet e Artit Poetik. Ajo mbetet në vete një pikë referimi, për krijues e studiues të letërsisë dhe artit poetik. Parimi poetik i Marinajt është i ndërtuar mbi eksperienca të shëndosha dhe perceptime të shumëfishta për artin dhe njeriun si epiqëndër e tij. Dhe këto gërshetohen nga ndjeshmëria e thellë humane, për të bukurën, për sublimen dhe kategoritë e saja estetike, për dashurinë si përjetësia e fjalëve dhe amshueshmëria e vargjeve. Brenda poezisë së Gjekë Marinajt, poetit, përkthyesit dhe profesorit të letërsisë, shkrihen në universin e pafundmë dy dimensionet themelore poetike: prirjes semantike, ku fjala dhe mesazhet tingëllojnë për të shpreh intencë ideor; dhe prirjes estetike, ku sintaksa e vargut është e kursyer, idetë, mesazhet, vishen me figuracion të zgjedhur, të seleksionuar, përmes një logosi e diskursit poetik, e cili metaforën dhe krahasimin i kombinon dhe kështu krijon tipologjinë e kënaqësive të lexuesit dhe më tej prodhon lexues të kënaqësive, (Roland Barthesi).

. Për fund, poezia e Gjeke Marinajt